



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 01.08.2025
Numër Protokolli: 5201/2025

A.nr.1157/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1157/2025 të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesi S.M, kundër organit të punësimit/Inspektoratit Qendror i Punës, në çështjen juridike “*Transferim pas rristrukurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1157/2025, të datës 18.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, S.M.

A r s y e t i m

Ankuesi, S.M (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), i punësuar nw Inspektoratin e Punës, më datë 18.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr. 1157/2025 dhe protokolluar me numër 4127/2025, kundër Vendimit me Nr. 1083 i datës 22.05.2025, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik DMZP/MPB, lidhur me transferimin pas rristrukurimit.

Tutje, ankuesi më datë 30.07.2025, përmes shkresës me numër protokolli 5144/2025 duke u bazuar në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është tërhequr nga ankesa me numër A.nr.1157/2025 e datës 18.06.2025.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 30.07.2025, të ankuesit për tërheqje nga ankesa A.nr.1157/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1157/2025 të datës 18.06.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1157/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit S.M;*
- *Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB,*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; si dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*